



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 3-të të KPF-së Lipjanit mbajtur, më 30.03.2026, në sallën numër 2 , kati i 3-të , me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Armend Grajçevci, anëtar
3. Anila Reçica - Llugiqi, anëtare
4. Elmaze Behluli, anëtare
5. Arsim Jashari, anëtar
6. Egzona Gashi, anëtare
7. Alban Salihu anëtar

Të tjerë prezent :

1. Diamant Bytyqiu, nënkryetar i komunes
2. Rasim Hasani, DKA
3. Rexhep Rexhepi, DBPZHR
4. Ajkuna Maliqi, DA
5. Sead Aliu, DSHPMM
6. Burim Rrustemi, DKRS

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i KPF-së Daut Azemi, pasi përshëndeti të pranishmit tha ju uroj suksese të rizgjedhurve në KPF, po ashtu edhe anëtarëve të rinjë duke ju dëshiruar suksese. Pastaj tha se rendin e ditës se bashku me material e keni marrë me kohë të cilin e lexoi në vazhdim.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 2-të e KPF-së.
2. Propozim Vendim për caktimin e lokacionit për Shkollën e Mesme Gjimnazi "Ulpiana" në Lipjan.
3. Propozim Vendim për miratimin e Planit komunal për riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Lipjanit 2026-2028.

4. Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për organizatën "QATAR CHARITY" për realizimin e projekteve për siguri ushqimore, konkretisht serra bujqësore dhe motokultivatorë me frezë kose, motokultivatorë me nfrezë kose dhe rimorkio.
5. Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për organizatën "QATAR CHARITY" për projektin e hapjes së puseve për ujë të pijës për familjet me kushte të rënda ekonomike.
6. Propozim Vendim për caktimin e lokacionit për fushë të futbollit në ZK-Babush i Muhaxherëve.
7. Propozim Vendim për ndryshimin dhe plotësimin e shtojcës A- tarifat e shërbimit të rregullores për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Lipjanit 15Nr.352-47361 të datës 30.09.2020.
8. Propozim Vendim për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve në Ndërmarrjen Publike Lokale "Pastrimi".
9. Propozim Vendim për themelimin e organit të kujdestarisë në kuadër të Qendrës për Punë Sociale në Lipjan.
10. Raport përmbledhës për dëmet e vlerësuara nga Komisioni komunal për vlerësimin e dëmeve në territorin e Komunës së Lipjanit për vitin 2025- Janar 2026.
11. Raport i Punës i Zyrës së Kryetarit dhe Drejtorateve Komunale Janar-Dhjetor 2025.
12. Informatë nga KRM "Pastrimi" Sh.A. për gjendjen e grumbullimit dhe transportit të mbeturinave në territorin e Komunës së Lipjanit.

Daut Azemi, tha se kemi edhe 1 pikë shtesë, të cilat ua shpërndajti me herët zyrtari i sektorit.

13. Propozim Vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare shoqatës sindikale të administratës komunale.

Meqë vërejtje as plotësime nuk pati Kryesuesi vuri në votim rendin e ditës dhe pas votimit konstatoi se KPF- ja me 7 vota për, aprovoi rendin e ditës me pikën e propozuar.

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 2-të e KPF-së.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pyeti a ka vërejtje apo plotësime rreth ekstraktit.

Meqë diskutime as vërejtje nuk pati nuk pati Kryesuesi vuri në votim dhe pas votimit konstatoi se KPF- ja me 7 vota për, aprovoi ekstraktit nga mbledhja e 2-të e KPF-së.

II

Propozim Vendim për caktimin e lokacionit për Shkollën e Mesme Gjinnazi “Ulpiana” në Lipjan.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, ia kaloi fjalën rasim Hasanit drejtor i DKA-se, i cili i njoftoi ne pika te shkurta.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin.

Arsim Jashari, tha ne emër te kunja aka qen ajo parcele deri tani?

Rasim Hasani, tha ka qen ne emër te shkollës bujqësore tani do te ndahet për gjimnazin Ulpiana.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF- ja me 7 vota për, aprovoi propozimin

III

Propozim Vendim për miratimin e Planit komunal për riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Lipjanit 2026-2028.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Diamant Bytyqit, nënkryetar i komunës, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin.

Arsim Jashari, tha e kam lexuar këtë plan por është mire hera tjera me pru një raport ne kuvend me dite se çfarë te arritura janë bere çka është realizuar.

Diamant Bytyqi, tha ke te drejt se zakonisht zyra lokale raporton te kryetari pro edhe ne kuvend hera tjera bën me raportuar.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF- ja me 7 vota për, aprovoi propozimin

IV

Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për organizatën “QATAR CHARITY” për realizimin e projekteve për siguri ushqimore,

konkretisht serra bujqësore dhe motokultivatorë me frezë kose, motokultivatorë me nfrezë kose dhe rimorkio.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Rexhep Rexhepit drejtor i BPZHR, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin.

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF- ja me 7 vota për, aprovoi propozimin

V

Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për organizatën “QATAR CHARITY” për projektin e hapjes së puseve për ujë të pijës për familjet me kushte të rënda ekonomike.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Rexhep Rexhepit drejtor i BPZHR, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin.

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF- ja me 7 vota për, aprovoi propozimin

VI

Propozim Vendim për caktimin e lokacionit për fushë të futbollit në ZK-Babush i Muhaxherëve.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Burim Rustemit, drejtor i DKRS, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin.

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF- ja me 7 vota për, aprovoi propozimin

VII

Propozim Vendim për ndryshimin dhe plotësimin e shtojcës A- tarifat e shërbimit të rregullores për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Lipjanit 15Nr.352-47361 të datës 30.09.2020.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Sead Aliu, drejtor i DSHPMM i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin.

Arsim Jashari, tha për momentin nuk është mirë me u rrit këto tarifa pasi që ju e dini si është gjendja ne teren që disa jave nuk janë mbledh miturinat edhe pse nuk është shume e madhe nëse rritet por nuk e meriton kjo kompani edhe pse ne si kuvend i kemi ndihmuar disa here me mjete financiare me derivate.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha po në i kemi ndihmuar disa here si kuvend dhe me te vërtet nuk është gjendja e mire ne këtë kompani por nuk po na lejohet as te ndahet kjo komani e as te bëjmë një ndërmarrje publike e as te lidhim kontrate me operator privat.

Burim Rrustemi, tha se qytetaret tanë janë shume te rregullt në pagesa mirëpo kompania për momentin ka disa probleme me prishje te mjeteve dhe është ne gjendje jo te mire, mirëpo kjo nuk e arsyeton këtë që po ndodhe.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF- ja me 7 vota për, aprovoi propozimin

VIII

Propozim Vendim për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve në Ndërmarrjen Publike Lokale "Pastrimi".

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Imri Semetishtit, DUMM, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin.

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF- ja me 7 vota për, aprovoi propozimin

IX

**Propozim Vendim për themelimin e organit të kujdestarisë në kuadër të
Qendrës për Punë Sociale në Lipjan**

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, ia dha Diamant Bytyqit, nënkryetar i komunës i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin.

Arsim Jashari, tha a kane veture zyrtarë QPS-ja, qe mund at shfrytëzoje 24 orë.

Diamant Bytyqi, tha se po kane vetura zyrtare qe mund ti shfrytëzojnë për 24 ore për punën e tyre ne QPS

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për, aprovoi propozimin

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha a pajtoheni qe te shkojnë direkt për kuvend për diskutim pikat:

11. Raport i Punës i Zyrës së Kryetarit dhe Drejtorateve Komunale Janar-Dhjetor 2025.

12. Informatë nga KRM "Pastrimi" Sh.A. për gjendjen e grumbullimit dhe transportit të mbeturinave në territorin e Komunës së Lipjanit.

13. Propozim Vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare shoqatës sindikale të administratës komunale.

Pastaj Kryesuesi vuri në votim propozimin dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për, aprovoi propozimin qe te shkojnë direkt për kuvend për diskutim këto pika.

Meqë çështje tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 11:20

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i KPF-së

Daut Azemi